

# INDEKSI I VOLUMIT TË PRODHIMIT NË INDUSTRI

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure  
(ESMS)  
INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	3
5. Periudha e referencës .....	3
6. Mandati institucional.....	3
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit.....	4
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	5
11. Menaxhimi i cilësisë .....	6
12. Rëndësia.....	6
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	8
15. Kohëzotueshmëria dhe krahasueshmëria.....	8
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente.....	11
Aneks .....	11

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Jesmina Mustafaj
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist në Sektorin e Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Kodi ZIP 1017, Tiranë.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:jmustafaj@instat.gov.al">jmustafaj@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	08.04.2022
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	08.04.2022
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	08.04.2022
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri (IPI) shërben për matjen e ndryshimeve tremujore në volumnin e prodhimit industrial. Burimi kryesor është Vrojtimi Tremujor i Statistikave Afatshkurtra, Pyetësori për industrinë (Moduli 121) kombinuar me të dhëna administrative.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi statistikor i aktiviteteve ekonomike kryhet sipas NACE Rev.2.
3.3. Mbulimi i sektorit	Vrojtimi tremujor përfshin ndërmarrjet e klasifikuara në Seksionet B, C, D dhe E të NACE Rev. 2. Anketa përfshin të gjitha ndërmarrjet e mesme të mëdha dhe të mesme, si dhe një numër përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla. Një shtresë përcaktohet sipas klasave dhe bazohet në numrin e të punësuarve.
3.4. Koncepte statistikore dhe	Qëllimi i Indeksit të Volumit të Prodhimit Industrial është të matë ndryshimet në

përkufizime	<p>volumit e prodhimit në interval të ngushtë dhe të rregullt, kryesisht tremujor dhe vjetor. Ai mundëson matjen e trendit të volumit në vlerën e shtuar gjatë një periudhe të caktuar referimi. Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri është një matës teorik që duhet të përafrohet me matjen praktike. Vlera e shtuar me çmime bazë mund të llogaritet nga shitjet neto (pa TVSH dhe taksa të tjera të ngjashme të zbritshme të lidhura drejtpërdrejt me shitjet neto):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• + prodhim i kapitalizuar,</li> <li>• + të ardhura të tjera operative</li> <li>• +/- ndryshimet në inventarë,</li> <li>• -blerjet e mallrave dhe shërbimeve,</li> <li>• -taksat për produktet të cilat janë të lidhura me shitjet neto, por nuk zbriten</li> <li>• + çdo subvencion për produktet e marra.</li> </ul>
3.5. Njësia statistikore	Njësia e vrojtuar është ndërmarrja.
3.6. Popullata statistikore	Popullsia statistikore përfshin njësitë statistikore, në këtë rast ndërmarrjet, të cilat operojnë në aktivitete ekonomike sipas NACE Rev. 2, Industri (seksionet B, C, D dhe E, përkatësisht ndarjet 05-39) sipas Regjistrimit Statistikor të Biznesit. Ndërmarrjet me 1-9 të punësuar janë vrojtuar me kampion, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë vrojtuar tërësisht.
3.7. Zona e referencës	Indeksi i Volumit të Prodhimit Industrial mbulon gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në nivel kombëtar.
3.8. Mbulimi në kohë	Vrojtimi tremujor i Statistikave Afatshkurtra referuar Indeksit të Volumit të Prodhimit Industrial daton prej vitit 2005 e në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Viti bazë: 2015 = 100, aplikohet duke filluar nga tremujori i parë 2019.
4. Njësia matëse	Njësitë e matjes janë indekset dhe ndryshimet në përqindje (%).
5. Periudha e referencës	Informacioni i grumbulluar dhe përpunuar i referohet periudhave tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2021.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjoreku mbështeten indikatorët e ATN-së konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Kombëtar i Statistikave</a></li> <li>• <a href="#">Statistikat Zyrtare Programi Kombëtar 2017-2021</a></li> </ul> <p>Klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Rregullorja e Këshillit Nr.1165 / 98</a> për futjen e statistikave afatshkurtra në nivel evropian</li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Komisionit Nr.1503/2006</a> që përcakton variablat dhe shpeshësinë e mbledhjes së të dhënave, shfuqizimin e porosive të reja të marra për ndërtimin e ndërtesave dhe porositë e reja të marra për inxhinierinë civile.</li> </ul>

6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Indeksi i Prodhimit në Industri (IPI) nuk transmetohen ende në Eurostat pasi përpilimi dhe publikimi i këtij treguesi bëhet në frekuencë tremujore. IPI transmetohet rregullisht në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) përmes (e-Gdds).
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe kërkimore bazuar në Ligjin Kombëtar të Statistikave Nr.17 / 2018 “Për Statistikat Zyrtare”, datë 10.03.2018 dhe Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Mbrojtja e të Dhënave Personale”. Në nenin 31 të ligjit të statistikave thuhet si vijon: Të dhënat e mbledhura për prodhimin e statistikave zyrtare do të trajtohen nga INSTAT si konfidenciale dhe do të përdoren vetëm në tabela të grumbulluara që nuk do të identifikojnë njësinë e informacionit burimor. Identifikimi i drejtpërdrejtë nënkupton kur një njësi statistikore është identifikuar drejtpërdrejt nga emri ose adresa e saj ose nga çdo numër i caktuar zyrtarisht dhe zakonisht i njohur. Kur përpunimi i të dhënave bëhet në atë mënyrë që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat menjëherë duhet të kodohen në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshme.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njesisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijojnë paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njesisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat

	njoftohen paraprakisht në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendari</a> i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikant zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara (me postë ose <a href="#">email</a> ); 3. Publikimi; 4. Seksioni <a href="#">Kërkesa të dhënash</a> , për përdoruesit e jashtëm.
<b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>	IPI shpërndahet me bazë tremujore.
<b>10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Statistikat Afat-Shkurtra. Formatit i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave Afatshkurtra publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT nën nëntemën: <a href="#">Statistikat Afat-Shkurtra</a> .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Statistikave Afatshkurtra. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: <a href="#">DatabazaStatistikore</a> .
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat e Statistikave Afatshkurtra nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për statistikant zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kontakt</a> .

10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ATN për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përlllogaritjen e indeksit dhe është i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare. Kjo i jep mundësinë stafit që të përftojë një pamje të plotë dhe në vijimësi rreth ndërmarrjeve dhe përgjegjësi të tyre.</p> <p>Është bërë një krahasim me të dhënat e vitit të kaluar për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdorues janë klasifikuar në të jashtëm dhe të brendshëm. Përdoruesit e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministritë dhe administrata publike që përdorin të dhënat për qëllime të planifikimit të politikave ekonomike dhe sociale.</li> <li>• Universitetet (profesorë/studentë të diplomuar dhe pasuniversitar), organizata kërkimore.</li> <li>• OJQ Kombëtare dhe Ndërkombëtare</li> <li>• Ndërmarrjet</li> <li>• Publiku i gjerë që merr informacionin përmes mediave nëpërmjet publikimeve të bëra nga Zyra e Statistikave.</li> </ul> <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarive Kombëtare</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve</li> <li>• Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Statistikat Afatshkurtra për vitin 2021 janë rreth 21,650 klikime.</p> <p>Gjatë 2021 INSTAT ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vërtetimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave Afat-Shkurtra është vlerësuar me 3.52 (70.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Statistikat afatshkurtra në tërësinë e tyre ndërtohen në përputhje me rregulloret e Eurostat. Shkalla e plotësisë së të dhënave të vërtetimit të ATN-së për vitin 2021 është 70.6%. Kjo llogaritje, përpilimi i Indeksit të Volumit të Prodhimit Industrial dhe të dhënat e ofruara janë në përputhje me Rregulloret përkatëse të BE-së.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave.</p> <p>Popullata e vëzhguar e Statistikave Afatshkurtra 2021 përfshin afërsisht 10,000 ndërmarrje për çdo tremujor, nga të cilat afërsisht 2,400 në aktivitetin Industrial. Dizajni i kampionimit është kampionim i thjeshtë i rastësishëm, i shtresëzuar. Kriteri i përdorur për shtresëzim është numri i personave të punësuar sipas NACE Rev.2 në nivel 3 shifror.</p> <p>Llogaritja e vlerësimeve të të dhënave statistikore dhe analiza e njësive outlier kryhet rregullisht. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të përgjigjes, shkalla e saktësisë së përgjithshme është e lartë. Për të llogaritur vlerësimet, përdoret vlerësuesi Horvitz-Thompson, që është i paanshëm. Saktësia e vlerësimeve arrihet duke eliminuar gabimet e kampionimit dhe të jo kampionimit, të tilla si mbulimi, pa përgjigje, gabimet e përgjigjes dhe gabimet e përpunimit.</p> <p>Arsyet e shfaqes së gabimeve në mbulim janë: keq klasifikimi i njësive dhe ndryshimet në statusin e njësive raportuese. Është e detyrueshme t'i përgjigjes vërtetimit. Në rast mos-përgjigje, njësitë kontaktohen përmes telefonit dhe postës elektronike. Gabimi në kampionim në përqindje (CV) llogaritet për treguesit kryesorë të vërtetimit që publikohen çdo tremujor.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Gabimet e kampionimit trajtohen në raportet e brendshme teknike, ku për çdo indikator në vërtetim llogaritet varianca e totalit, si dhe gabimi standart relativ, për eliminimin e efektit negativ që jep lëvizja e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes në serinë kohore të vlerave. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.</p>



13.3. Gabim jo i kampionimit	<p><b>Mos-përgjigja në nivel rekordi</b> merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën.</p> <p>Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi mesatarisht për ATN 2021 është 3.09%.</p>
------------------------------	--

## 14. Afatet kohore dhe përpikmëria

14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Indeksit të Volumit të Prodhimit në Industri janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 75 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 75 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Indeksit të Volumit të Prodhimit në Industri është 31 Dhjetori 2021.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/16/2022</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>75</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e publikimit	3/16/2022	Afatet kohore	75
Periudha referuese	12/31/2021						
Data e publikimit	3/16/2022						
Afatet kohore	75						

14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Indeksit të Volumit të Prodhimit në Industri publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Prodhimit në Industri ka qënë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>3/16/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/16/2022</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e shpallur	3/16/2022	Data e publikimit	3/16/2022	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e shpallur	3/16/2022								
Data e publikimit	3/16/2022								
Vonesa në kohë	0								

## 15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Të dhënat në lidhje me ATN (IPI) janë përgatitur në përputhje me metodologjinë e Eurostat dhe janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.</p>
-----------------------------------	---

15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Ndër vite Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri ka pësuar ndryshime në fushën e mbulimit dhe në metodën e zgjedhjes. Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve ka filluar për herë të parë në vitin 2005. Ndërmarrjet më 1-9 të punësuar janë me kampionim, ndërsa ndërmarrjet me mbi 10 të punësuar janë marrë me listim (në mënyrë ekzostive) pa ndryshuar fushën e mbulimit. Në vitin 2012 ndryshon popullsia si rezultat i përditësimit të Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve me rezultatet e Rregjistrimit të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2010. Të gjitha ndryshimet janë raportuar në shpjegimet metodologjike që shoqërojnë publikimet përkatëse. Në vitin 2014 në Indeksin e Volumit të Prodhimit në Industri u implementua nomenklatura e aktiviteteve ekonomike, NVE Rev. 2, struktura e azhornuar e peshave dhe ndryshimi i periudhës bazë të indekseve nga 2005 në 2010. Në vitin 2019 në SASH përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2010 në 2015. Të gjitha këto ndryshime në serinë e indekseve nuk janë shkëputur, por indekset janë kthyer mbrapa në kohë. Këto ndryshime janë raportuar në shpjegimet metodologjike që</p>
------------------------------	---



	<p>bashkohen me botimet përkatëse.</p> <p>Të dhënat e Statistikave afatshkurtra sipas tremujorëve bazuar në Klasifikimin e Aktivitetit Ekonomik NVE Rev 2, datojnë që nga viti 2006 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 16 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=16).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri është vlerësuar duke përdorur të dhënat e TVSH. Për ndërmarrjet që të dhënat e TVSH nuk janë të disponueshme është përdorur vërtetim me zgjedhje. Nuk ekziston informacion tjetër statistikor, i cili mund të përdoren për kontrollin e koherencës.</p>
15.4. Koherenca e brendshme	<p>Koherenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar përpara se ato të finalizohen. Lidhja midis variablave është kontrolluar dhe koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave është konfirmuar. Specialistët e statistikave afatshkurtra punojnë së bashku me specialistë të drejtorive përkatëse për të siguruar qëndrueshmërinë dhe koherencë të treguesve statistikor.</p>
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	<p>Kostoja e Statistikave Afatshkurtra përfshin informacion mbi numrin e stafit të përhershëm dhe të përkohshëm. Numri i stafit të ATN është:</p> <p>Totali i stafit në Zyrën Qendrore: 1 punonjës</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Specialistët e logjistikës 1 punonjës</li> <li>• Kontrollorë 9 të punësuar</li> <li>• Operatorë 9 të punësuar</li> <li>• Anketues 150 të punësuar</li> </ul> <p>Transmetimi i të dhënave administrative mundësohet pa kosto përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara midis INSTAT, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Burimet Statistikore (Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ATN e mëparshme) janë gjithashtu pa kosto, pasi janë konsideruar si përdorues të brendshëm. Stafit i ATN menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që edhe këto dy procese nuk kanë kosto të tjera shtesë.</p>
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantuara nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul> <p>E njëjta politikë revizionimi aplikohet ndaj publikimeve dhe transmetimeve kombëtare në Eurostat.</p>
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare ato mund të rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: implementimi i klasifikimit të ri NVE, ndryshime metodologjike, burime të reja informacioni</p>

	<p>ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve. Rishikimi i tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katërt tremujorët.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime mbi të dhënat e “Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri” për vitin 2021. Nuk ka vlerësime numerike të indikatorëve MR dhe MAR.</p>
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Të dhënat bazohen në anketat statistikore tremujore dhe të dhënat administrative. Baza e përzgjedhjes është Regjistri i ndërmarrjeve aktive për vitin referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NACE Rev. 2. Popullata në studim përcaktohet nga dy kriteret themelore: Madhësia e ndërmarrjes (bazuar në numrin e të punësuarve) dhe aktiviteti ekonomik brenda fushës së studimit, me prerje. Metoda e përdorur e përzgjedhjes është Përzgjedhje e thjeshtë e Rastit me Shtresëzim. Shtresëzimi bazohet në kombinimin e aktivitetit ekonomik me grupin e madhësisë së ndërmarrjes. Treguesit janë paraqitur për aktivitete ekonomike sipas fushave të përcaktuara në rregulloren e Statistikave Afat-Shkurtra dhe gjithashtu bazuar në nevojat e përdoruesve.</p>
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mblidhen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe intervistimet të drejtpërdrejtë nga anketuesit pranë ndërmarrjeve. Kohëzgjatja e intervistimit të drejtpërdrejtë ishte 15 ditë pas tremujorit referues dhe u krye vetëm për ndërmarrjet të cilat nuk ishin subjekt i deklarimit në burimet administrative.</p> <p>Gjatë vitit referencë nuk është planifikuar ndryshim në pyetësor.</p>
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Të dhënat e marra nga vrojtimi dhe nga skedari i TVSH-së vlerësohen duke përdorur rregulla logjike të vlefshme.</p> <p>Në nivel kombëtar, editimi përfshin studimin e të dhënave të të anketuarve me qëllim identifikimin (dhe korrigjimin) e gabimeve. Jo të gjitha gabimet mund të identifikohen, por qëllimi është të zbulohen ato gabime që kanë ndikim të madh tek rezultatet.</p> <p>Rregullat për identifikimin e gabimeve mund të vënë në dukje gabime të mundshme të cilat kërkojnë një studim të mëtejshëm për të kuptuar se ku qëndron gabimi përkundrejt një rezultati të pazakontë ose mund të evidentojnë gabime të përcaktuara. Redaktimi (editimi) përfshin kontrolle për tërësinë, që vlerat janë brenda kufijve të caktuar dhe se vlerat për variablat e lidhur janë koherent. Redaktimi i të dhënave mund të bëhet gjatë ose pas hedhjes së të dhënave.</p> <p>Përgjigjet mund të krahasohen me përgjigjen e tremujorëve të mëparshëm. Mospërputhja ose devijimet e mëdha (jashtë një diapazoni të paracaktuar) tregojnë se një studim më i thellë do ishte i rëndësishëm. Kjo mund të rezultojë në redaktim të dhënash. Në kontekstin e afatit kohor, procesi i redaktimit mund</p>

	<p>të jetë i dizajnuar për t'i dhënë përparësi kryesore atyre njesi outlier që kanë më shumë nevojë për redaktim për hir të agregateve të besueshëm. Me zgjidhjen e rasteve më të këqija, mund të arrihen përmirësime të mëdha.</p>
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p><b>Nivel Kombëtar</b></p> <p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga të dhënat administrative dhe intervistat e drejtpërdrejta në ndërmarrje.. Qëllimi është për të sjellë këtë informacion në nivelin statistikor. Proçesi i ndjekur është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli fizik i plotshmërisë së pyetsorëve.</li> <li>• Kontrolli logjik i pyetsorëve (kontrolli i shënimit logjik të indikatorëve të përgjigjes, përshkrimit të aktivitetit dhe kodifikimit si dhe kontrolli i plotësimit të shifrave).</li> <li>• Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë redaktimit (editimit).</li> <li>• Mos-përgjigjet dhe mungesa e informacionit për ndërmarrjet e rëndësishme (ndërmarrjet e mëdha) duhet të plotësohen nëpërmjet proçesit të imputimit duke përdorur informacionin e marrë nga burime të tjera.</li> <li>• Krahasueshmëria e të dhënave (ndërmjet të dhënave të vrojtimit dhe të dhënave administrative, periudhat e mëparshme ose trendet).</li> <li>• Analiza e rezultateve për çdo fushë publikimi (domein).</li> <li>• Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit.</li> <li>• Të dhënat e agreguara krahasohen me të dhëna nga burime të tjera</li> <li>• Dy fazat e fundit mund të jenë subjekt analizash të tjera, në funksion të rezultateve sipas fushave të publikimit (domein-et).</li> </ul> <p>Së fundi, kur analiza statistikore ka përfunduar, këto të dhëna përcaktohen si grup informacioni jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është ruajtja e konfidencialitetit të këtij informacioni.</p>
<p>18.6. Rregullimi</p>	<p>Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri llogaritet i përshtatur sezonalisht dhe i papërshtatur sezonalisht.</p> <p>Përshtatja sezonale në seritë tremujore të Prodhimit zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori 1 2006 - Tremujori IV 2021. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme, Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit, komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.</p>
<p><b>19. Komente</b></p>	
<p><b>Aneks</b></p>	